



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 45, Datë 10.05.2024

“Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për “Rektor” dhe “Anëtar Senati Akademik” në Universitetin e Tiranës, në kuadër të procesit të zgjedhjeve të përgjithshme për autoritetet dhe organet drejtuese të Universitetit të Tiranës”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, nenet 17, 18, 22 dhe 23, si dhe Urdhrit të Rektorit të UT-së, nr. 2, datë 21.3.2024 “Për shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës”, në mbledhjen e datës 10.05.2024, KIZ i UT-së:

VENDOSI:

1. Të shpallë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për “Rektor” dhe “Anëtar Senati Akademik” në Universitetin e Tiranës.
2. Kandidatët mund të regjistrohen në datat 13, 14, 15, 16 dhe 17 maj 2024, pranë Sekretarisë së KIZ në Rektoratin e UT-së, ose elektronikisht, në adresën kizut2021@unitir.edu.al, nga ora 08.00-16.00, sipas Formularëve bashkëngjitur këtij vendimi.
3. Kandidatët studentë për “Anëtar Senati” në Universitetin e Tiranës aplikojnë sipas kriterëve të përshkruara në Rregullore.
4. Ky Vendim të publikohet në mjedise të dukshme të Fakulteteve, Institutit të Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Filialit Sarandë të UT-së, në faqen e tyre zyrtare dhe në faqen zyrtare të UT-së.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---------------------|-----------|----------|
| 1. Leticja Gusho | (Kryetar) | |
| 2. Alnida Koroshi | (Anëtar) | |
| 3. Arjan Tushaj | -//- | (mungon) |
| 4. Eljon Doçe | -//- | |
| 5. Etlon Peppo | -//- | |
| 6. Shaniko Allajbeu | -//- | |
| 7. Dhurata Saraçi | -//- | |

